



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-17436/23
Kaçanik, 25.07.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 25 korrik 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët- të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Nënkryetari i Komunës –Sabedin Vishi, Bahri Selimi-DBF, Qamil Stagova-DUKMM.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.
Procesmbajtës: Maviye Murseli Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 25 korrik, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2023;
3. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Runjevë ;
4. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Begracë;

Lidhur me rendin e propozuar të punës, e hapi diskutim: Për diskutim nuk u paraqit kush, Rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa ndonjë vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 26.06.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-14567/23.

2. Raporti Gjashhtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Në raportin gjashtë mujor financiar për periudhën Janar-Qershor të vitit 2023, kemi paraqitur të gjithë ecurinë për këtë periudhë lidhur me shpenzimet dhe të hyrat. Në tabelën e parë, e keni shtyllën e parë e cila paraqet buxhetin e miratuar për vitin 2023, pastaj mund ta vëreni shtyllën e dytë të buxhetit e cila paraqet buxhetin e tanishëm e cila dallon nga shtylla e buxhetit të miratuar vetëm në shumën e bartjeve të të hyrave vetanake. E kam cekur që edhe një pjesë të të hyrave kemi me i bart, e që në fakt jemi duke i bartur tani. Raportin 9-të mujor kur ta sjellim keni me i pas, këtu po shënon që të hyrat e bartura nga viti 2022 në vitin 2023 janë 498,529.00 euro por edhe 320,000.00 euro i kemi nga viti 2021 që kanë kaluar me vonë dhe të cilat do barten në buxhetin e këtij viti që d.m.th. është lejuar shfrytëzimi i tyre.

Buxheti aktual nuk është i dobët, masa monetare e buxhetit është 11 milion 173 mijë euro, ku deri më tani janë shpenzuar mjetet në vlerë prej 4 milion 50 mijë euro që d.m.th buxheti është shpenzuar 36,23% për periudhën janar-qershor të vitit 2023. Te pagat buxheti është shpenzuar 53%, te mallrat 25%, në komunal 21%, subvencionet 28% si dhe te shpenzimet kapitale afërsisht 15%. Si masë monetare krahasuar me periudhën e vitit 2022, në vitin 2023 janë shpenzuar 1(një) milion euro më shumë mjete, këtu ka reflektuar edhe ligji i pagave, afër 500.000 euro apo 20 % më shumë kanë kushtuar pagat, pastaj tek shpenzimet kapitale janë realizuar më shumë pagesat krahasuar me vitin e kaluar, për 424,000.00 euro më shumë. Kemi pasur disa kontrata dyvjeçare dhe kjo na ka ndihmuar që ti realizojmë pagesat në mënyrë që mos me i pritë procedurat e prokurimit pa u bo transferet e periudhës paraprake. Tek të hyrat vetanake jemi shumë mirë edhe këtu është arritur me shpallje të realizimit 60.66%.

Pozicionet apo zërat e të hyrave vetanake që kanë reflektuar më shumë janë: tatimi në pronë, tatimi në tokë, lejet e ndërtimit, taksat komunale për leje ndërtimi, taksa për leje mjedisore etj. Vetëm direkte janë 60.66 %, apo shuma e inkasuar është 523,200 euro nga 862,560 euro sa i kemi të planifikuara.

Tabelat që i kemi ofruar paraqesin veçanërisht kategoritë e mallrave dhe shërbimeve dhe kategorinë e investimeve kapitale, një ashtu janë të paraqitura në detaje për secilën drejtori si: sa projekte janë shpenzuar për secilën drejtori, sa kanë buxhet të planifikuar, sa i kanë pasur shpenzimet për periudhën 6 mujore dhe sa janë mjete të lira deri në fund të vitit. Subvencionet po ashtu kemi paraqitur në detaje sipas përfitueseve.

z. Agim Mani: Sipas sqarimit nga drejtori i financave lidhur me çështjen e miratimit të buxhetit, vërehet që me të vërtet ka pasur një realizim të mirë të të hyrave, sidomos nga tatimi në pronë, ku fatmirësisht qytetaret e kanë kuptuar që është obligim dhe duhet ta paguajnë prandaj ky ka sjell rezultatin deri 87% .

Shembull tek administrata e përgjithshme te taksat e certifikatës së lindjes janë realizuar vetëm 6.1% . Pse aq pak? Investimet apo shpenzimet kapitale a janë 14.85 apo a janë 12.13 cila është e saktë. Tek tabela e planifikimit të zhvillimit ekonomik nuk keni paraparë asnjë shumë.

Te rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve urbane dhe rurale, për rrugët urbane janë shpenzuar mjetet në vlerë 7,498.00 euro ndërsa për rrugët rurale janë shpenzuar mjetet në vlerë prej 22,000.00 euro, a është kjo shuma e saktë që është realizuar?

znj. Kadrije Lika-Troni: Tek raporti financiar i të hyrave vetanake, në tabelën e paraqitur tregohen të hyrat e realizuara sipas drejtorive dhe llojeve, mirëpo të tjerat nuk keni mundur me i paraqit shkaku i sistemit bazuar në raporte bankare, domethënë disa drejtori i kanë kategoritë

e paraqitura por Drejtoria për Arsim dhe Kulturë nuk i ka, d.m.th. kjo është e rregulluar sigurisht prej nivelit qendror apo nivelit komunal, andaj a duhet me qenë me kode llojet e ndara. Sistemi i komunës sonë, a gjeneron raport të llojeve kur i regjistrojmë në nivel komune, me qëllim që ti identifikojmë se cili departament na sjell të hyrat, për shembull tek kultura kur është fjala palestra me konstatua se sa na ka sjellë të hyra për periudhën 6 mujore.

z. Bahri Selimi: Te zhvillimi ekonomik nuk ka subvencione shtesa, 10,000.00 euro që janë paraqitur në kategorinë e shpenzimeve kanë të bëjnë me paga. Shpenzimi i vetëm që ka realizuar kjo drejtori ka të bëjë me pagën, me ç'rast kjo drejtori i ka tre persona të punësuar dhe pagat kanë kushtuar 10,476.00 euro, ndërsa kategoritë e tjera i ka zero dhe deri në këtë periudhë 6 mujore nuk ka paguar as subvencione.

Te urbanizmi, për rrugët rurale i ka 190.000.00 euro buxhet me të gjitha burimet e financimit, ku 22,430.00 euro i ka të realizuara shpenzime.

Sa i përket pyetjes së znj. Kadrije, lidhur me raportin për të hyra, të hyrat janë me plan kontabël për secilën të hyrë sipas llojeve, të miratuar nga ministria.

Lidhur me pyetjen se Investimet apo shpenzimet kapitale a janë 14.85% apo janë 12.13%, e ceka edhe me lartë që buxheti i shpenzuar për investimet kapitale është afërsisht 15%.

z. Agim Mani: Tenderimet kanë filluar në muajin Prill dhe kanë përfunduar procedurat e prokurimit për rregullimin e rrugëve urbane, kurse brenda dy muajve punë-kryesi nuk ka arritur me përfundua punën as në fazën e parë, ndoshta ka qenë dashur të ju jepet më shumë që d.m.th. as 10% nuk ju kanë dhënë, është edhe plani dinamik dhe fazat që është dashtë me u bë, por që në fakt nuk janë krye, andaj ju lutem na njoftoni ku ka ngec ky proces dhe pse pagesa nuk është realizuar sipas planit dinamik?

Kryesuesi i Kuvendit: Këto mjete janë të parapara të shpenzohen për rrugët rurale, duhet të ceket që ky proces varet se kur ka filluar tenderimi, në muajin maj apo muajin qershor, procedura e tenderimit është një muaj, madje është në pyetje një muaj e gjysmë deri sa ai ka filluar me punë në këto rrugë lokale, po ashtu punë-kryesi është në proces tenderimit, për detaje më të hollësishme duhet ti drejtoheni drejtorisë për shërbime publike.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e ,**Diskutoj Raportin Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2023. Ky raport financiar i kalohet KK në procedurë për diskutim.**

3. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private, ZK Runjevë;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Material shumë voluminoz mirëpo cili është interesi i komunës në këtë rast?

z. Qamil Stagova: Është e vërtet që interesi është më shumë i qytetareve që jetojnë aty, por edhe është në interes edhe të komunës sepse kjo rrugë drejtohet dhe tek e fundit komuna është për me i ndihmuar qytetareve, këtu prej dy pronareve merret tokë në sipërfaqe 161.60m² kurse pas zhvendosjes se rrugës domethënë lëshohet një sipërfaqe 161.32m², sipërfaqja është e njëjtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private, ZK Runjevë. Ky propozim vendim i

Rekomandohet
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private „ZK Begracë;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Me çka e dëshmon që ky shkëmbim i pronës domethënë që ka dëshmuar pronari qe parcela përbëhet prej fletës poseduese mirëpo prona e komunës nuk ka kurrfarë dëshmie që është pronë e komunës përveç që e ka një numër të parcelës kurrgjë ma tepër.

z. Qamil Stagova: Është pjesë e parcelës 2420-3, me sipërfaqe 69m², ka qenë dhe është shfrytëzim ndërsa për me rregulluar këtë bashkojnë me një rrugë tjetër dhe i japin tokë me sipërfaqe 122m², sa për informatë nuk janë ngjitas afër dhe janë në territor Begracës me një largësi 2 km ndërmjet vete.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, a jeni që kjo pikë t'i shkoj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e

Aprovoj

Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private „ZK Begracë .Ky propozim vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:40.
Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët - 07.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 31.07.2023 në ora 11:00.

Procesmbajtëse
Mavije Murseli



Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli

